

AKT THEMELIMI DHE STATUT "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR
"ASKII TECHNOLOGIES" SHPK**

AKT THEMELIMI DHE STATUT "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "Askii Technologies "SHPK
KREU I**

EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

Sot, më 17/08/2021 (dymijë e njëzet e një), ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "ASKII TECHNOLOGIES " SHPK

NENI 1

EMRI I SHOQERISE

Emri i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte " ASKII TECHNOLOGIES " SHPK (me poshte e quajtur "Shoqeria").

NENI 2

SELIA

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Andon Zako Cajupi,shkalla 3,kati6, AP nr.14 Tirane.Asambleja e Pergjithshme mund te vendosi mbi transferimin e selise se Shoqerise ne nje adrese tjeter. Organi administrues i Shoqerise mund te themeloje ose mbylle dege dhe/ose zyra perfaqesimi, brenda apo jashte Republikes se Shqiperise

NENI 3


KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është e papërcaktuar duke filluar nga dita e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

NENI 4

OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqeria ka per objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, duke u fokusuar kryesisht ne:



AKT THEMELIMI DHE STATUT "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK

Sherbime informatike ; Trejetimi i software; Konsulenc per projektimin dhe drejtimin e platformave dixhitale; Pergatitja dhe furnizimi direkt dhe indirekt me sherbimet informatike, telematike, marketingut, tajnim dhe mbeshtetje te integruar logjistike, per zhvillimin e trejetise tradicionale dhe elektronike te cfaredo lloj aktiviteti, si nepermjet internetit ashtu edhe kanaleve tradicionale. Programin, zhvillim dhe mirembajtje te sistemeve te software, programin, zhvillim te faqeve web dhe aplikacioneve mobile. Furnizim software dhe konsulence informatike, Projektim dhe planifikim i sistemeve IT qe perfshije si pjesen hardware, software dhe teknologjive te komunikimit; Sigurimi i shërbimeve për aplikimin, organizimin dhe zhvillimin e teknologjive të informacionit; Konsulencë dhe instalim i kompjuterëve; Përpunimi elektronik i të dhënave; Menaxhimi, mirëmbajtja evolucionare dhe korrigjuese, integrimi dhe anulimi i bazave të të dhënave;

Shoqeria mund te veproje ne Shqiperi dhe jashte saj dhe te kryeje cdo aktivitet tjetër te lidhur, ndihmes me qellim te permbush ose te jete i dobishem per permbushjen e objektit te saj.

KREU II


KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 Leke, i ndare ne 4 (kater) kuota. Kapitali i Shoqerise nenshkruhet menjehere dhe do te paguhet nga ortaket qe zoterojne 100 % (njeqind perqind) te kontributeve ne kapitalin e shoqerise, perkatesisht:

- Z. Naidi Shuli, shtetas shqiptar, i lindur ne Durres, dtl 27.03.1995, identifikuar me numer personal J555327067N, zotërues i nje kuote, me pjesëmarrje në përqindje 25% me një kontribut prej 25.000 (Njezet e pese mij) Lekë.;
- Z. Kostandin Angjellari, shtetas shqiptar, i lindur ne Leskovik, dtl 20.05.1994, identifikuar me numer personal J40520081I, , zotërues i nje kuote, me pjesëmarrje në përqindje 25% me një kontribut prej 25.000 (Njezet e pese mij) Lekë
- Z.Redi Muharremi, shtetas shqiptar, i lindur ne Durres, dtl 08.03.1997, identifikuar me numer personal J70308076B, , zotërues i nje kuote, me pjesëmarrje në përqindje 25% me një kontribut prej 25.000 (Njezet e pese mij) Lekë



AKT THEMELIMI DHE STATUT "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK

- Z.Rushan Xhaja, shtetas shqiptar, i lindur ne Çorovode, dtl 19.06.1994, identifikuar me numer personal J40619063I, , zotërues i nje kuote, me pjesëmarrje në përqindje 25% me një kontribut prej 25.000 (Njzet e pese mij) Lekë;

Ne rast zmadhimi apo zvogelimi te kapitalit themeltar te Shoqerise, ortakët do te kene te drejten e nenshkrimimit te zmadhimit apo zvogelimit te kapitalit ne perpjese tim te drejte me pjesemarrjen qe zoteron secili ne kapitalin e Shoqerise.

NENI 6

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHEGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT

Ne rast se nje ortak apo nje bashkezoterues i nje kuote humb jeten, trashegimtarët e tij do te jene te vetmet persona qe do ti njihet titulli mbi kuotat nga Shoqeria; por asnje nga keto parashikime nuk liron pergjegjesite e trashegimtareve nga cdo detyrim i mbartur nga kuota e zoteruar. Ne rastin e vazhdimit te Shoqerise me disa trashegimtare te ortakut qe ka humbur jeten, trashegimtarët duhet te caktojne nje perfaqesues te perbashket.

Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e humbjes se jetes ose falimentimit te nje ortaku mund te zgjedh e te behet zoterues i kuotes ose te kerkoj regjistrimin e kuotes ne emer e nje personi tjetër te caktuar prej tij si perfitues i kuotes. Nese personi i mesiperm zgjedh te behet zoterues i kuotes, ai njofton Shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje.


Nese personi i mesiperm zgjedh te kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjetër atehere a i duhet ta kryeje ate nepermjet nje akti te vlefshem te transferimit te kuotes.

Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e humbjes se jetes ose falimentimit te nje ortaku do te kete te drejta qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te dejte ne pjese marrjes ose te votes ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne regjistrin tregtar si zoterues i kuotes.

NENI 7

ZMADHIMI I KAPITALIT

Asambleja e Pergjithshme mund te zmadhoje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme per zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve qe jane thirrur por nuk ishin te pranishem ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme qe vendosi per zmadhimin e kapitalit.



AKT THEMELIMI DHE STATUT "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK

Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithë ortaket do te kene te drejten te nenshkruaj ne zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne perpjestim te drejte me kuotat qe zoterojne ne Shoqeri.

Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta nenshkrimin te pjeses se tyre, kapitali i parashkruar mund te nenshkruhet nga ortaket e tjere. Ne kete rast, keta ortake mund te ushtrojne serish te drejten per nenshkrimin e kapitalit, ne per pjesetim te drejte me kuotat e pjesemarrjes ne Shoqeri.

NENI 8

ZVOGELIMI I KAPITALIT

Asambleja e Pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 te ketij Akti Themelimi dhe Statuti. Ne cdo rast, kapitali i Shoqerise nuk mund te zvogelohet nen kufirin e percaktuar me ligj.

Ortaket e perballojne zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, ne perpjesetim te drejte me pjese marrjen e tyre ne kapitalin e Shoqerise

KREU III

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME


NENI 9

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme vendos mbi te gjitha ceshtjet per te cilat eshte kompetente sipas ligjeve ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, sipas ketij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose cdo marreveshje midis ortakeve te Shoqerise.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme, te shprehi vullnetin e tij si dhe te votoje ne perputhje me pjesen e kapitalit qe ai zoteron ne Shoqeri.

Cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjetër ose nga nje perfaqesues i deleguar me prokure me shkrim.



AKT THEMELIMI DHE STATUT "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK

Ortaku nuk mund te delegoje te drejten e votes per nje pjese te kuotave te tij te te kapitalit, nese ai voton personalisht per pjesen e mbetur

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme mund te mbahet brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen ose video, ne perputhje me legjislacionin per shoqerite tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme do te quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nenshkruhet procesverbali perkates.

Asambleja e Pergjithshme mund te thirret nga Administratori/et ose nga ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerise. Thirrja e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme duhet te behet nepermjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, derguar secilit prej ortakeve ne adresat e njoftuara Shoqerise, te pakten 15 (pesembedhete) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e saj. Njoftimi duhet te permbaje rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes.

Asambleja e Pergjithshme do te mblidhet rregullisht, pavaresisht nga keto formalitete, ne rast se te gjitha ortaket apo perfaqesuesit e tyre jane te pranishem dhe bien dakord per rendin e dites.

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme kryesohen nga Administratori/et. Asambleja e Pergjithshme cakton nje sekretar per cdo mbledhje midis personave te pranishem.

Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te jene me shkrim dhe te firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kerkese te ortakeve, vendimet duhet te perfshijne dhe deklaratat apo verejtjet e tyre.

Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Asambleja e Pergjithshme, ne rastin e vendimeve qe kerkojne shumicen e zakonshme, merr vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote ose perfaqesuesit e tyre, qe zoterojne me shume se 30% (tridhete per qind) te kapitalit te Shoqerise, pervec rasteve te parashikuara me poshte ne nenin 9.12. Ne rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Pergjithshme thirret ne nje mbledhje te dyte brenda 30 (tridhete) diteve nga mbledhja e pare.


Asambleja e Pergjithshme vendos me votat pro te cdo ortakeve pjesemarres apo te perfaqisuar qe zoterojne me shume se 50% te kapitalit te Shoqerise per ndryshimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 10

ADMINISTRIMI I SHOQERISE



AKT THEMELIMI DHE STATUT "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK

Shoqeria administrohet nga nje apo me shume Administratore te cilet zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme per nje periudhe prej 5 (pese) vjetesh. Administratori mund te rizgjidhet dhe shkarkohet ne cdo kohe nga Asambleja e Pergjithshme.

Administratori zoteron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise, pervec atyre qe ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblese se Pergjithshme apo organeve te tjera te Shoqerise.

Administratori vepron ne perputhje me politikat tregtare te vendosura nga Administratori eshte pergjegjes per veprimet e kryera nen administrimin e Shoqerise. Administratori mund te delegoje persona te trete per kryerjen e veprimeve dhe akteve qe kane te bejne me administrimin e Shoqerise, duke mbajtur pergjegjest per te gjitha veprimet e kryera nga te tretet e deleguar per administrimin e Shoqerise.

Administratori do te veproje ne cdo kohe vetem ne interesin me te mire te Shoqerise. Ne rast konflikti interesi, Administratori do te njoftoje menjehere ortaket si dhe do te heqe do re nga cdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhezimeve nga Asambleja e Pergjithshme.

Administratori i pare i Shoqerise do te jete:

- Z. Naidi Shuli, shtetas shqiptar, i lindur ne Durres, dtl 27.03.1995, identifikuar me numer personal J555327067N,

NENI 11

SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

Asambleja e Pergjithshme percakton shperblimin e Administratorit te Shoqerise.


PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

- a) i perfundon mandati;
- b) shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- c) jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqerine;
- d) personi nuk gezon cilesine e Administratorit sipas parashikimeve te ligjit;
- e) mungon pa arsye ne detyre per me shume se 6 (gjashte) muaj radhazi dhe Asambleja e Pergjithshme vendos ta shkarkoje nga detyra.

KREU V

KONTROLLI FINANCIAR I SHOQERISE, VITI FINANCIAR, BILANCI YJETOR, DIVIDENDI



NENI 13
KONTROLI FINANCIAR

Kontrolli financiar i Shoqerise kryhet ne perputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme do te emeruje nje apo me shume Ekspert Kontabel te Autorizuar ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

NENI 14
VITI FINANCIAR

Viti Financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

NENI 15
BILANCI VJETOR

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe te Ekspertit Kontabel te Autorizuar (nese jane emeruar) miratohen nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori i paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme raportin mbi administrimin e Shoqerise dhe llogarite vjetore.

Dokumentet qe kane te bejne me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 16
DIVIDENTI

Pasi te jene permbushur kerkesat e percaktuara nga Ligji per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, Shoqeria, me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese te Pergjithshme, mund te vendos shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe i bashkengjiten kuotave, te gjithë dividendet duhet te deklarohen dhe paguhen sipas shumave te paguara ne kuotat ne te cilat paguhet dividenti. Te gjithë dividendet do te shperndahen dhe paguhen ne menyre proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjate cdo pjese ose pjeseve te periudhes ne te cilen paguhet dividenti.

KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM,
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE



AKT THEMELIMI DHE STATUT "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK

NENI 17

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rastin e prishjes dhe likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara n e ligjin per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

NENI 18

LIGJI I ZBATUESHEM

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushen e Shoqerive Tregtare.

NENI 19


ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet Shoqerise dhe ortakëve, apo ndermjet ortakëve dhe trashëgimtareve te ortakëve ose ortakëve te tjere dhe/ose Shoqerise, qe kane per objekt te drejta te lidhura me Shoqerine, do te zgjidhen miqesisht ndermjet paleve te interesuara. Ne rast se palet nuk arrij ne nje zgjidhje miqesore, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane do te jete kompetente per zgjidhjen e mos marreveshjeve.


Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje te njejta ne gjuhen shqipe.

ORTAKET

Naidi Shuli




Kostandin Angjellari



AKT THEMELIMI DHE STATUT "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK

Rushan Xhaja

Rushan Xhaja


Redi Muharremi

Redi Muharremi
